

VENDIM
Nr. 49/2015

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË EMËRIMEVE NË DETYRË TË REALIZUARA GJATË PERIUDHËS 15 SHTATOR 2013 DERI MË 31 MAJ 2014, NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE, ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË TREGTARE SHTETËRORE”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 82/2014, NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3/2015

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë të realizuara gjatë periudhës 15 shtator 2013 deri më 31 maj 2014, në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 82/2014, ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 3/2015, zgjatet për një periudhë 1-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 16.4.2015

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

Zhvillimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në vijim “Zyra e Komisionerit”, si institucion i pavarur, i cili, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, mbikëqyr, monitoron e kontrollon të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Rolin aktiv në monitorimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, veprimtarinë ndërgjegjësuere të Komisionerit për sensibilizimin e qytetarëve dhe institucioneve publike, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që lindin nga zbatimi i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Rolin aktiv në monitorimin e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, veprimtarinë ndërgjegjësuere të Komisionerit për sensibilizimin e qytetarëve dhe institucioneve publike, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që lindin nga zbatimi i legjislacionit të të dhënave personale.

Angazhimet e Komisionerit për rritjen e performancës në ushtrimin e kompetencave të tij ligjore, me theks të veçantë në proceset e inspektimit, shqyrtimit të ankesave, rritjen e numrit të njoftimeve e regjistrimeve nga kontrolluesit, ndjekjen e procedurave gjyqësore.

Zhvillimin e kuadrit ligjor në dhënien e mendimeve për projektakte ligjore e nënligjore dhe në miratimin e udhëzimeve dhe udhërrëfyesve.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2014:

Zyra e Komisionerit, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka hartuar dhe miratuar “Programin Model të Transparencës” për autoritetet publike, si dhe ka vazhduar monitorimin e procesit të implementimit të programit të transparencës nga institucionet publike.

Zyra e Komisionerit ka rritur numrin e inspektimeve, shqyrtimit të ankesave, kontrolleve, krahasuar me vitin 2013, në kontrollues publikë e privatë, krahasuar me vitin 2013.

Zyra e Komisionerit ka pasur rol më proaktiv në monitorimin e zbatimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve të saj.

Është organizuar konferenca për autoritetet publike dhe koordinatorët, me synim ndërgjegjësim e tyre për ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ka ndjekur një strategji më efikase në drejtim të dhënies së masave administrative, në rast të shkeljes së legjislacionit për të dhënat personale. Ka rritje të zbatimit të sanksioneve administrative, ushtrimin e kësaj kompetence ligjore, në krahasim me vitin e kaluar.

Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar ngushtë-sisht me kontrollues publikë dhe privatë, për të rritur njoftimet dhe regjistrimet.

Zyra e Komisionerit ka dhënë mendime ligjore, për projektakte ligjore e nënligjore, me synim përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit ka hartuar disa udhëzime për sektorë të veçantë dhe udhërrëfyesve, për të disiplinuar punën e kontrolluesve dhe për t'i nxitur ata për konsultimet e projektakteve dhe hartimin kodeve të etikës.

Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore.

Zyra e Komisionerit ka rritur nivelin e bashkëpunimit ndërinstitutional me institucione si ILDKPKI-në, Prokurorinë e Përgjithshme, AKEP-in, AMA-n, Avokatin e Popullit.

Zyra e Komisionerit ka luajtur rol aktiv në trajnimin e personave të ngarkuar në bashkëpunim me ASPA-n.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2015 kërkon:

Rritjen e numrit të inspektimeve dhe riinspektimeve me tematikë në sektorë të ndryshëm, që mbledhin e përpunojnë të dhëna personale.

Monitorimin e zbatimit të udhëzimeve, rekomandimeve, që ky institucion ka lënë për kontrollues publikë dhe privatë pas procesit të hetim-inspektimeve.

Krijimin e një “regjistri kombëtar” online për koordinatorët e caktuar nga autoritete publike, si detyrim që rrjedh nga ligji për të drejtën e informimit.

Monitorimin e zbatimit të programit të transparencës në të gjitha institucionet publike, vendore dhe qendrore, si dhe kryerjen e sondazheve në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit.

Komisioneri duhet të nxisë subjektet e ndryshme, publike dhe private, për të dërguar pranë Komisionerit për mendim çdo akt, projektakt ligjor e nënligjor, dokumente të ndryshme juridike, marrëveshje, që kanë lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Angazhimin në vazhdimësi për dhënien e opinioneve ligjore, gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjeve në komisionet parlamentare, që kanë lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, dhe së drejtës për informim, dhënie asistence në përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

Angazhimin më të madh publik në nxitjen e kontrolluesve për hartimin e kodeve të etikës dhe vlerësimin e tyre, në respekt të nenit 31, pika 1, shkronja “gj”, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Angazhimin maksimal të Komisionerit, në drejtëm të një identifikimi sa më të plotë të subjekteve kontrolluese e përpunuese dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e subjekteve kontrolluese.

Konsolidimin e bashkëpunimit me AKEP-in, lidhur me monitorimin procesit të shkatërrimit të të dhënave personale të shtetasve, nga kompanitë mobile, si një detyrim që kompanive u rrjedh nga ligji i AKEP-it.

Monitorimin e procesit të transferimeve ndër-kombëtare të të dhënave, kryesisht në sektorë strategjikë si telefoni, banka, në funksion të mbrojtjes më të mirë të të dhënave personale të qytetarëve.

Nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive, (AMA), me qëllim monitorimin e etikës në media, ndërgjegjësimin e tyre në njohjen dhe zbatimin e ligjeve respektive.

Nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, me qëllim trajtimin e rasteve me objekt të drejtën e informimit, në referencë të përmbajtjes së nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 16.4.2015